



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 25.10.2023

Nr: 184

Ora: 13:15

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 33, DATË 25.10.2023 TË KOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 25.10.2023, me pjesëmarrjen e:

| | | | |
|----------------|----------------|---|----------------|
| Elvis | ÇEFA | - | Relator |
| Elvin | LAKO | - | Anëtar |
| Ilirjan | RUSMALI | - | Anëtar |
| Koli | BELE | - | Anëtar |
| Ledio | BRAHO | - | Anëtar |

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Gëzim Topçiu,
kryetar i bashkisë Maliq

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019,
datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 33 regj., datë 19.10.2023. Në mbledhjen e datës 25.10.2023, ora 13:15, pas relatimit të z. Elvis Çefa, u konstatua se kërkesa i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 33, datë 19.10.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 26.10.2023, ora 13:30.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

| | | | |
|----------------|----------------|---|----------------|
| Elvis | ÇEFA | - | Relator |
| Elvin | LAKO | - | Anëtar |
| Ilirjan | RUSMALI | - | Anëtar |
| Koli | BELE | - | Anëtar |
| Ledio | BRAHO | - | Anëtar |